

LIGJ
Nr. 107/2015

PËR IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SHËRBIMET E BESUARA*†
(ndryshuar me ligjin nr. 123/2016, datë 15.12.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kuadrit të nevojshëm ligjor për identifikimin elektronik të sigurt, vulat elektronike, shërbimin e transmetimit elektronik dhe autentifikimin e faqeve të internetit në Republikën Shqipërisë.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për shërbimet e besuara, në mënyrë të veçantë për transaksionet elektronike, si dhe për skemat e identifikimit elektronik.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për ofrimin e shërbimeve të besuara të përdorura ekskluzivisht në sisteme të mbyllura, të cilat rrjedhin nga legjislacioni kombëtar apo marrëveshje ndërmjet një grupi të caktuar pjesëmarrësish, si dhe në rastet kur në legjislacionin në fuqi parashikohet ndryshe.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autentifikim” është një proces elektronik që mundëson identifikimin elektronik të sigurt të një personi fizik ose juridik apo konfirmimin e origjinës dhe integritetin e të dhënave në formë elektronike.

2. “Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik”, në vazhdim Autoriteti, është institucioni publik, sipas ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.

3. “Certifikatë për autentifikim faqesh interneti” është vërtetimi, nëpërmjet të cilit bëhet i mundur autentifikimi i një faqeje interneti dhe që lidh faqen e internetit me personin fizik apo juridik, të cilit i është lëshuar kjo certifikatë.

4. “Certifikatë e kualifikuar për autentifikim faqesh interneti” është certifikata për autentifikim

*Ky ligj është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr.910/2014 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 23 korrik 2014 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, dhe që shfuqizon direktivën 1999/93/KE”, Numri CELEX 32014R0910, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr. L257, datë 28.8.2014, faqe 73-114.

† Ligji nr. 107/2015, datë 1.10.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 182, datë 21 tetor 2015.

Ligji nr. 123/2016, datë 15.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 259, datë 6 janar 2017.

faqesh interneti, e cila është lëshuar nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar dhe plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

5. “Certifikatë për vulë elektronike” është vërtetimi elektronik që lidh të dhëna të vërtetimit të vlefshmërisë së vulës elektronike me një person juridik dhe konfirmon emrin e këtij personi.

6. “Certifikatë e kualifikuar për vulë elektronike” është një certifikatë për vulë elektronike, që është lëshuar nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar dhe plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

7. “Identifikim elektronik i sigurt” është procesi i identifikimit elektronik të një personi fizik dhe verifikimi i vërtetësisë së identitetit të tij, nëpërmjet përdorimit të të dhënave të identitetit personal në formë elektronike, të cilat përfaqësojnë në mënyrë unike personin fizik apo juridik, ose personin fizik që përfaqëson personin juridik.

8. “Identifikim fillestar” është verifikimi i identitetit të aplikuesit për pajisjen me mjete të identifikimit elektronik.

9. “Krijuesi i një vule elektronike” është një person juridik, i cili krijon një vulë elektronike.

10. “Mbjatës i mjetit të identifikimit” është personi fizik, të cilin ofruesi i shërbimit të identifikimit e ka pajisur me mjet identifikimi, bazuar në një marrëveshje të pranuar nga palët.

11. “Mjet i krijimit të vulës elektronike” është produkt *software* ose *hardware* i konfiguruar për këtë qëllim, i cili përdoret për të krijuar një vulë elektronike.

12. “Mjet i krijimit të vulës elektronike të kualifikuar” është një mjet i krijimit të vulës elektronike, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

13. “Mjete të identifikimit elektronik” është një njësi materiale dhe/ose jomateriale që përmban të dhënat e identifikimit personal, të cilat mundësojnë identifikimin elektronik të sigurt dhe autentifikimin në një shërbim *online*.

14. “Ofrues i shërbimit të besuar” është personi fizik ose juridik, i cili ofron një ose më shumë shërbime të besuara si ofrues i kualifikuar ose jo i kualifikuar i shërbimeve të besuara.

15. “Ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar” është ofruesi i shërbimit të certifikimit, sipas ligjit nr.9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i cili, përveç shërbimeve të përcaktuara në këtë ligj, mund të ofrojë edhe shërbime të tjera të besuara të kualifikuara.

16. “Organizëm i testimit dhe konfirmimit” është subjekti fizik ose juridik, sipas ligjit “Për nënshkrimin elektronik”, i cili, përveç ofrimit të shërbimit të certifikimit, kryen vlerësimin e konformitetit edhe të ofruesve të shërbimeve të besuara.

17. “Palë të përfshira” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët mbështeten mbi një shërbim të identifikimit elektronik ose mbi shërbime të tjera të besuara.

18. “Skemë e identifikimit elektronik” është tërësia e mjeteve dhe sistemeve të identifikimit elektronik, të nevojshme për të kryer procesin e identifikimit elektronik të sigurt.

19. “Shërbim i besuar” është shërbimi elektronik, i cili konsiston në krijimin, verifikimin dhe vërtetimin e vlefshmërisë së vulave elektronike, shërbime të regjistruara të transmetimit elektronik dhe të certifikatave të lidhura me këto shërbime, ose krijimin, verifikimin dhe vërtetimin e vlefshmërisë së certifikatave për autentifikim faqesh interneti, ose mundësimin e identifikimit elektronik të sigurt nëpërmjet mjeteve të identifikimit elektronik të përdorura brenda një skeme të identifikimit elektronik, ruajtjen e vulave ose certifikatave që lidhen me këto shërbime.

20. “Shërbim i besuar i kualifikuar” është një shërbim i besuar, i cili ofron nënshkrime elektronike të kualifikuara dhe vula kohore të kualifikuara, sipas ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, vula elektronike të kualifikuara, shërbim të regjistruar të kualifikuar të transmetimit elektronik, certifikata të kualifikuara për autentifikim faqesh interneti, mundësimin e identifikimit elektronik të sigurt nëpërmjet mjeteve të identifikimit elektronik të përdorura brenda një skeme të identifikimit elektronik, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

21. “Shërbim i transmetimit elektronik” është një shërbim që bën të mundur transmetimin e të dhënave midis palëve të treta nëpërmjet mjeteve elektronike dhe siguron provë në lidhje me trajtimin e të dhënave të transmetuara, përfshirë dëshmitë për dërgimin e marrjen e të dhënave dhe që mbron të dhënat e transmetuara kundër rrezikut të humbjes, vjedhjes, dëmtimit apo çdo ndryshimi të

paautorizuar.

22. “Shërbim i kualifikuar i transmetimit elektronik” është një shërbim i transmetimit elektronik, i cili plotëson kriteret e parashikuara në këtë ligj.

23. “Të dhëna të identifikimit personal” është një tërësi të dhënash, nëpërmjet të cilave mundësohet identifikimi i personit fizik ose personit juridik, ose personit fizik që përfaqëson personin juridik.

24. “Të dhëna të krijimit të vulës elektronike” janë të dhënat unike, të cilat përdoren nga krijuesi i vulës elektronike për të krijuar një vulë elektronike.

25. “Të dhëna të vërtetimit të vlefshmërisë” janë të dhëna, të cilat përdoren për të vërtetuar një nënshkrim elektronik ose vlefshmërinë e një vule elektronike.

26. “Transaksion elektronik” nënkupton blerjen apo shitjen e mallrave apo shërbimeve, të kryera ndërmjet personave fizikë, personave juridikë, publikë apo privatë, nëpërmjet rrjeteve kompjuterike.

27. “Vërtetim vlefshmërie” është procesi i verifikimit dhe konfirmimit të vlefshmërisë së një nënshkrimi elektronik ose një vule elektronike.

28. “Vulë elektronike” janë të dhënat në formë elektronike, të cilat janë bashkëngjitur ose të lidhura logjikisht me të dhëna të tjera elektronike, për të siguruar origjinën dhe integritetin e këtyre të fundit.

29. “Vulë elektronike e kualifikuar” është vula elektronike, e cila është krijuar nga një pajisje krijimi vule elektronike të kualifikuar dhe është e bazuar në një certifikatë të kualifikuar për vulë elektronike.

KREU II

IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK I SIGURT

Neni 4

Vlefshmëria ligjore e identifikimit elektronik të sigurt

Identifikimi elektronik i sigurt mundësohet nëpërmjet mjeteve të identifikimit elektronik, të lëshuara sipas një skeme identifikimi elektronik nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar, me qëllim përfitimin e shërbimeve elektronike.

Të dhënat personale, të krijuara nëpërmjet identifikimit elektronik të sigurt, do të merren të mirëqena dhe të vërteta dhe kanë të njëjtën vlerë ligjore me të dhënat e përftuara nga identifikimi i një personi fizik nëpërmjet dokumentit zyrtar të identifikimit.

Neni 5

Garancia e skemës së identifikimit elektronik

Skema e identifikimit elektronik siguron shkallë të lartë besueshmërie për identitetin e pretenduar apo të pohuar të personit dhe karakterizohet nga specifikime teknike, standarde dhe procedura të lidhura me to, përfshirë këtu kontrolle teknike, qëllimi i të cilave është të ulin riskun e keqpërdorimit apo të ndryshimit të identitetit.

Specifikimet teknike, standardet dhe procedurat për nivelet e garancisë së besueshmërisë së identifikimit elektronik përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Kërkesat për procedurat e identifikimit të sigurt

Procedurat e identifikimit të sigurt plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Identifikimi fillestar duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji, ku të dhënat e lidhura me të duhet të jenë të verifikueshme në çdo kohë.
2. Garantojnë identitetin e mbajtësit të mjeteve të identifikimit.
3. Garantojnë përdorimin vetëm nga mbajtësi i mjeteve të identifikimit.

Neni 7

Kushtet për identifikimin fillestar
(hiqen fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 123/2016, datë 15.12.2016)

1. Identifikimi fillestar bëhet me paraqitjen fizike të kërkuarit të mjetit të identifikimit elektronik. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar kontrollon në mënyrë të sigurt identitetin e kërkuarit, nëpërmjet letërnjoftimit.

2. Në rastet kur ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar nuk është në gjendje të verifikojë identitetin e kërkuarit, vërtetimi i identitetit dhe verifikimi i letërnjoftimit elektronik bëhen nga organi kompetent që ka lëshuar këtë dokument.

Neni 8

Certifikata elektronike për identifikim elektronik të sigurt

Certifikata elektronike e nevojshme për identifikim elektronik të sigurt përmban minimalisht:

- a) informacionin për ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar;
- b) informacion për zotëruesin e certifikatës;
- c) periudhën e vlefshmërisë së certifikatës;
- ç) të dhëna identifikuese të certifikatës;
- d) kufizimet e mundshme të përdorimit të certifikatës;
- dh) çelësin publik të mbajtësit të certifikatës;
- e) nënshkrimin elektronik të kualifikuar të ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar.

Neni 9

Pajisja me mjete të identifikimit elektronik të sigurt

1. Pajisja me mjete të identifikimit elektronik të sigurt bazohet në një marrëveshje me shkrim ndërmjet aplikuesit për mjet identifikimi elektronik dhe ofruesit të shërbimit të besuar.

2. Periudha e vlefshmërisë së mjeteve të identifikimit mund të jetë më e shkurtër se periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes.

3. Mjetet e identifikimit i lëshohen gjithmonë personit fizik.

4. Çdo mjet i identifikimit lidhet në mënyrë unike me mbajtësin e tij.

Neni 10

Bashkëpunimi dhe ndërveprimi

Ofruesi i shërbimit të identifikimit elektronik të sigurt bashkëpunon dhe ndërvepron me institucione shtetërore dhe private, nëpërmjet skemave të identifikimit elektronik të sigurt, të cilat ofrojnë shërbime elektronike, me qëllim autentifikimin e personave fizikë apo juridikë.

KREU III

SHËRBIMET E BESUARA DHE AUTORITETI PËRGJEGJËS

Neni 11

Aksesi për personat me aftësi të kufizuara

Shërbimet e besuara dhe produktet e përdoruesve fundorë, të përdorura në ofrimin e këtyre shërbimeve, bëhen të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 12

Autoriteti përgjegjës

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik.

Neni 13

Regjistrimi i ofruesve të shërbimit të besuar

Autoriteti regjistron emrat e ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar, si dhe ata të cilët kanë ndërprerë veprimtarinë, sipas nenit 31 të këtij ligji.

Ky regjistër përditësohet dhe publikohet në formë elektronike.

Neni 14

Ndërprerja e veprimtarisë së ofruesit të shërbimit të besuar nga Autoriteti

Autoriteti ndërpret përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht veprimtarinë e ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar, siç parashikohet në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik".

Neni 15

Certifikatat e kualifikuara

Lëshimi, shfuqizimi dhe revokimi i certifikatave të kualifikuara do të kryhen sipas parashikimit në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik".

Neni 16

Inspektimi dhe bashkëpunimi

Autoriteti inspekton ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar, të cilët janë të detyruar të bashkëpunojnë, siç parashikohet në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik".

KREU IV

OFRUESIT E SHËRBIMIT TË BESUAR

Neni 17

Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të besuar

1. Ofruesi i shërbimit të besuar, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të aktivitetit të tij, paraqet pranë Autoritetit kërkesën për regjistrim për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

2. Ofruesi i shërbimit të besuar duhet të provojë se zotëron:

a) besueshmërinë e nevojshme dhe njohuritë e specializuara, të duhura, për ushtrimin e veprimtarisë si ofrues i shërbimit të besuar;

b) garancinë e nevojshme financiare për dëmshpërblimet e mundshme, sipas nenit 30 të këtij ligji.

3. Ofruesi i shërbimit të besuar punëson personel të besueshëm dhe përdor produkte të besueshme.

4. Autoriteti verifikon nëse ofruesi i shërbimit të besuar dhe shërbimet e ofruara prej tij janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

5. Nëse Autoriteti konstaton se ofruesi i shërbimit të besuar dhe shërbimet e besuara të ofruara prej tij janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji, ai i jep statusin "i kualifikuar".

6. Ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara fillojnë të ofrojnë shërbimet e besuara të kualifikuara pas përfitimit të statusit të përmendur në pikën 5 të këtij neni.

7. Autoriteti përcakton formatet dhe procedurat, për qëllime të këtij neni, me anë të udhëzimeve.

8. Kushtet dhe kriteret, që duhet të përmbushë ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar, përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Ruajtja e të dhënave dhe dokumentimi i masave të sigurisë

Ruajtja e të dhënave nga falsifikimi dhe siguria e fshehtësisë së kodeve, dokumentimi i masave të sigurisë dhe certifikatave të kualifikuara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar bëhen në përputhje me përcaktimet në ligjin nr.9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik".

Neni 19

Raportimi i rrethanave të pamundësisë së përmbushjes së kushteve

Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar siguron se do të përmbushë kushtet e parashikuara në nenin 17, të këtij ligji, gjatë gjithë kohëzgjatjes së ushtrimit të veprimtarisë. Çdo rrethanë, që e bën të

pamundur një gjë të tillë, i raportohet menjëherë Autoritetit.

Neni 20

Transferimi i detyrave të shërbimeve të besuara

Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar, në pamundësi për ushtrimin e aktivitetit, mund t'ua transferojë personave të tretë detyrat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, nëse këta persona plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë ligj për ushtrimin e aktivitetit.

Transferimi nuk përfshihet përgjegjësinë e ofruesit të shërbimit për detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.

Neni 21

Raportimi i ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar tek Autoriteti

Çdo ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar paraqet një raport vjetor të hollësishëm për veprimtarinë e vet, jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës. Gjithashtu, ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar raporton tek Autoriteti sa herë që ky i fundit i kërkon informacion.

KREU V

VULAT ELEKTRONIKE

Neni 22

Efektet juridike të vulave elektronike

1. Vula elektronike e kualifikuar konsiderohet e pranueshme në procedurat ligjore, pavarësisht se është në formë elektronike.

2. Integriteti i të dhënave, me të cilat lidhet vula elektronike e kualifikuar, dhe saktësia e origjinës së tyre do të merren si të vërteta.

3. Një vulë elektronike e kualifikuar, bazuar në një certifikatë të kualifikuar, të lëshuar nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore me vulën e njomë.

Neni 23

Kërkesat për vulat elektronike të kualifikuara

Një vulë elektronike plotëson kërkesat e mëposhtme:

1. Lidhet në mënyrë unike me krijuesin e vulës.
2. Identifikon krijuesin e vulës.
3. Krijohet duke përdorur të dhënat e krijimit të vulës elektronike, të cilat përdoren vetëm nga krijuesi i vulës.
4. Lidhet me të dhënat të cilave u referohet, në mënyrë të tillë që çdo ndryshim i mundshëm i tyre të jetë i dallueshëm.
5. Bazohet në një certifikatë elektronike të kualifikuar.

Neni 24

Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike

Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike përmbajnë:

- a) të paktën një tregues në format të përshtatshëm për përpunimin e automatizuar, për sa i përket faktit që certifikata është lëshuar si certifikatë e kualifikuar për krijimin e vulës elektronike;
- b) një grup të dhënash, të cilat identifikojnë në mënyrë të sigurt dhe unike ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar, i cili lëshon certifikatën e kualifikuar, duke përfshirë, për një person juridik, të paktën emrin dhe numrin unik të identifikimit të subjektit;
- c) të dhënat për vërtetimin e vlefshmërisë së vulës elektronike, të cilat korrespondojnë me të dhënat për krijimin e një vule elektronike;
- ç) të dhëna të hollësishme për fillimin dhe përfundimin e periudhës së vlefshmërisë së certifikatës;

d) kodin e identifikimit të certifikatës, i cili duhet të jetë unik për ofruesin e kualifikuar të shërbimeve të besuara;

dh) nënshkrimin elektronik ose vulën elektronike të ofruesit të kualifikuar të shërbimeve të besuara, i cili lëshon certifikatën;

e) vendndodhjen ku certifikata përkatëse e nënshkrimit elektronik ose vulës elektronike, të referuara në shkronjën “dh”, të këtij neni, mund të gjendet pa pagesë;

ë) vendndodhjen e shërbimeve që mund të përdoren në lidhje me statusin e vlefshmërisë së certifikatës së kualifikuar;

f) kur të dhënat për krijimin e një vule elektronike lidhen me të dhënat e vlefshmërisë së saj dhe janë vendosur në pajisjen për krijimin e një vule elektronike të kualifikuar, një tregues i përshtatshëm për këtë fakt duhet të mundësohet në një format për përpunimin automatik.

Neni 25

Pajisjet e krijimit të vulës elektronike të kualifikuar

Pajisjet e krijimit të vulës elektronike të kualifikuar duhet të përmbushin kriteret dhe specifikimet teknike për pajisjet e sigurta të krijimit të nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.

KREU VI

SHËRBIMI I TRANSMETIMIT ELEKTRONIK

Neni 26

Efektet juridike të shërbimit të transmetimit elektronik

1. Të dhënat e dërguara dhe të marra nëpërmjet shërbimit të kualifikuar të transmetimit elektronik konsiderohen të pranueshme në procedurat ligjore, pavarësisht se janë në formë elektronike.

2. Të dhënat e dërguara dhe të marra nëpërmjet shërbimit të transmetimit elektronik të kualifikuar garantojnë integritetin e të dhënave, dërgimin e të dhënave nga dërguesi i identifikuar, pranimin e tyre nga ana e marrësit të identifikuar, si dhe saktësinë e datës e të orës së dërgimit dhe marrjes.

Neni 27

Kërkesat për shërbime elektronike të kualifikuara për transmetimin elektronik

(ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 123/2016, datë 15.12.2016)

Shërbimet elektronike të kualifikuara të transmetimit elektronik plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) ofrohen nga një ose më shumë ofrues të kualifikuar të shërbimit të besuar;

b) sigurojnë me një nivel të lartë sigurie identifikimin e dërguesit;

c) sigurojnë identifikimin e të adresuarit para transmetimit të të dhënave;

ç) dërgimi dhe pranimi i të dhënave garantojnë nga një nënshkrim elektronik i kualifikuar ose nga një vulë elektronike e kualifikuar e një ofruesi të kualifikuar të shërbimeve të besuara në mënyrë të tillë që të përjashtohet mundësia e ndryshimeve të pazbulueshme tek të dhënat;

d) çdo ndryshim i të dhënave, i nevojshëm për qëllimin e dërgimit apo pranimit të të dhënave, i tregohet në mënyrë të qartë dërguesit dhe marrësit të të dhënave;

dh) data dhe ora e dërgimit dhe pranimit, si dhe çdo ndryshim i të dhënave tregohen nga një vulë kohore elektronike e kualifikuar.

Rregullat për ofrimin e shërbimeve publike elektronike, që përfitohen nëpërmjet transmetimit elektronik, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII

AUTENTIFIKIMI I FAQEVE TË INTERNETIT

Neni 28

Kërkesat për certifikata të kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit

Certifikatat e kualifikuara për autentifikimin e faqeve të internetit plotësojnë kërkesat e poshtëshënuara, si të kenë:

- a) një tregues në format të përshtatshëm për përpunimin e automatizuar në lidhje me faktin që certifikata është lëshuar si certifikatë e kualifikuar për autentifikimin e faqes së internetit;
- b) të dhëna, të cilat identifikojnë në mënyrë unike ofruesin e kualifikuar të shërbimeve të besuara, i cili lëshon certifikatën e kualifikuar, duke përfshirë të paktën:
 - i) për personat fizikë: emrin e personit, të cilit i është lëshuar certifikata;
 - ii) për personat juridikë: emrin e personit juridik, të cilit i është lëshuar certifikata dhe, aty ku është e aplikueshme, numrin e regjistrimit, siç është regjistruar në të dhënat zyrtare;
- c) të dhëna për adresën, përfshirë vendbanimin e personit fizik apo juridik, të cilit i është lëshuar certifikata dhe, aty ku është e aplikueshme, siç është regjistruar në të dhënat zyrtare;
- ç) emrin e *domain*-it ose *domain*-eve të administruar/a nga personi fizik apo juridik, të cilit i është lëshuar certifikata;
- d) të dhëna të hollësishme për fillimin dhe përfundimin e periudhës së vlefshmërisë së certifikatës;
- dh) kodin e identifikimit të certifikatës, i cili duhet të jetë unik për ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar;
- e) nënshkrimin elektronik ose vulën elektronike të ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar që lëshon certifikatën;
- ë) të dhëna për vendndodhjen ku certifikata përkatëse me nënshkrimin elektronik ose vulën elektronike të referuar në shkronjën “e”, të këtij neni, mund të gjendet pa pagesë;
- f) të dhëna për vendndodhjen e shërbimeve që mund të përdoren në lidhje me statusin e vlefshmërisë së certifikatës së kualifikuar.

KREU VIII

PËRGJEGJËSIA LIGJORE

Neni 29

Shpërblimi i dëmit

1. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar dëmshpërblen personat e tretë, për çdo dëm të shkaktuar, në rastet kur:

- a) shkel kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- b) produktet e tij për shërbime të besuara të kualifikuara të sigurisë teknike nuk funksionojnë siç duhet.

2. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar përjashtohet nga detyrimi për shpërblimin e dëmit, kur provon se ka vepruar pa faj ose personat e tretë kanë pasur dijeni për ekzistencën e shkaqeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Në rastet kur ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar informojnë klientët e tyre paraprakisht, në lidhje me kufizimet për përdorimin e shërbimeve që ato ofrojnë dhe kur këto kufizime janë të njohura edhe nga palët e treta, ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar nuk do të jenë përgjegjës për dëmet, që rrjedhin nga përdorimi i shërbimeve, që tejkalojnë kufizimet e bëra të njohura.

4. Barra për të provuar dashjen apo pakujdesinë për dëmin e shkaktuar nga një ofrues jo i kualifikuar i shërbimit të besuar i ngarkohet personit fizik ose juridik që pretendon dëmin e përmendur më lart.

Neni 30

Garancitë pasurore

Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar është i detyruar të marrë masat e duhura financiare, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve ligjore, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008,

“Për nënshkrimin elektronik”.

Neni 31

Veprimet pas ndërprerjes së veprimtarisë së ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar

1. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar i raporton menjëherë Autoritetit ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë.

2. Në rast të ndërprerjes së veprimtarisë, ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar duhet që menjëherë:

a) të kujdeset që certifikatat e vlefshme të kalojnë nën kontrollin e një ofruesi tjetër të shërbimeve të besuara dhe të mbështetë ofruesin zëvendësues, duke i vënë në dispozicion të gjitha të dhënat e nevojshme;

b) nëse parashikimet shkronjën “a”, të kësaj pike, janë të pamundura për t’u realizuar, të shfuqizojë të gjitha certifikatat elektronike të vlefshme;

c) të informojë mbajtësit e certifikatave elektronike për ndërprerjen e veprimtarisë së tij dhe pasojat lidhur me të.

Neni 32

Përdorimi dhe dorëzimi i të dhënave

Përdorimi dhe dorëzimi i të dhënave nga ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar kryhen sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.

Neni 33

Organizmi i testimit dhe konfirmimit

Organizmi i testimit dhe konfirmimit përmbush kriteret e parashikuara në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.

Neni 34

Pranimi dhe përdorimi i produkteve të huaja

(shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 123/2016, datë 15.12.2016)

Produktet e besuara, të krijuara nga ofruesi i kualifikuar të shërbimit të besuar jashtë Republikës së Shqipërisë, do të njihen vetëm nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë me shtetet e tjera.

Për Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Europian dhe janë të akredituar nga autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një Ofrues i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar, që operon në Republikën e Shqipërisë.

Neni 35

Tarifat

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, miraton masën dhe llojet e tarifave që ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar duhet t’i paguajnë Autoritetit, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Vlerat e tarifës nuk mund të jenë më të mëdha se kostot e shërbimit të kryer nga Autoriteti.

KREU IX

MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 36

Kundërvajtjet

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Me gjobë 1 milion lekë për shkeljet e mëposhtme:
 - a) kur nuk zbatohen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë, sipas nenit 17 të këtij ligji;
 - b) kur nuk përmbushen kërkesat e përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji;
 - c) kur nuk bashkëpunohet me Autoritetin, në zbatim të neneve 16, 21 dhe 32 të këtij ligji.
2. Me gjobë 2 milionë lekë për shkeljet e mëposhtme:
 - a) kur nuk njoftohet për fillimin e veprimtarisë, sipas nenit 17 të këtij ligji;
 - b) kur nuk përmbushen kërkesat dhe kushtet për identifikimin e sigurt, sipas neneve 6 dhe 7 të këtij ligji;
 - c) kur nuk ndërmerren veprimet e kërkuara pas ndërprerjes së shërbimit të besuar, sipas nenit 31 të këtij ligji.

Të ardhurat nga gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 37

Masa të tjera

Pavarësisht nga masat e parashikuara në nenin 36, si dhe kushtet që përcaktohen në nenin 14, të këtij ligji, kur autoriteti e gjykon të arsyeshme se shkeljet janë në atë masë apo natyrë sa cenojnë integritetin dhe besueshmërinë e ofruesit të shërbimeve, ndërpret përkohësisht, plotësisht apo pjesërisht veprimtarinë e ofruesit të shërbimeve të besuara.

Neni 38

Ankimi dhe ekzekutimi

1. Kundër vendimit të dënimit me gjobë apo masave të ndërprerjes së veprimtarisë bëhet ankim te ministri përgjegjës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni.
2. Ministri merr vendim brenda 30 ditëve. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën administrative, brenda 45 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit.
3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen në përputhje me ligjin "Për kundërvajtjet administrative".

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 39

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, 17 dhe 35 të tij.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9279, datë 15.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani